



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN

AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 818 Prot

Datë 20.04.2016

Lënda: Dërgohet Raporti i Vlerësimit Teknik i Dokumentit "Analiza dhe Vlerësimi i Territorit", Lot 8 - Bashkia Pogradec, Korçë; shoqëruar me Proces-Verbalin e vlerësimit.

Drejtuar: Znj. Eglantina GJERMENI
Ministër
Ministria e Zhvillimit Urban

Për Dijeni: Z. Sotiraq Filo
Kryetar
Bashkia Korçë

Z. Eduart Kapri
Kryetar
Bashkia Pogradec

Bashkimi i Operatorëve ekonomik BOLLES&WILLSON GmbH&CO dhe IDRA sh.p.k

Adresa: Rr. "Siri Kodra", Nr. 94, Ap.49, Njësia Bashkiake 8, Tiranë

E nderuar Znj. Gjermeni,

Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar; të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit"; të VKM Nr. 670, datë 29.07.2015 "Për ngarkimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për kryerjen e procedurave të prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 bashki", Urdhrit të Ministres së Zhvillimit Urban Nr. 48, datë 17.02.2016 "Për monitorimin, mbikëqyrjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratave si dhe marrjen në dorëzim të produktit, për tenderin "Shërbim Konsulencë", me objekt Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për 26 bashkitë", i ndarë në lote; "Termave të Referencës për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 Bashki"; të Kontratës "Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për Bashkitë: Pogradec, Korçë" të nënshkruar më datë 27.01.2016, Nr. Prot. 514 mes palëve Ministria e Zhvillimit Urban dhe Bashkimi i Operatorëve ekonomik BOLLES&WILLSON GmbH&CO dhe IDRA sh.p.k, Ju dërgojmë bashkëlidhur:

1. Raporti i Vlerësimit Teknik për dokumentin "Analiza dhe Vlerësimi i Territorit", për Lotin 8, Bashkia Pogradec;
2. Raporti i Vlerësimit Teknik për dokumentin "Analiza dhe Vlerësimi i Territorit", për Lotin 8, Bashkia Korçë;
3. Proces-Verbalin e Vlerësimit të mbajtur për Fazën I, "Analiza dhe Vlerësimi i territorit", për Lotin 8, Bashkia Pogradec, Korçë.

Me respekt,

Adelina GRECA

DREJTORE E PËRGJITHSHME





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Datë ___/___/2016

PROCES – VERBAL

FAZA 1: Analiza dhe Vlerësimi i Territorit

LOTI 3: Bashkia Pogradec, Korçë

I mbajtur sot nga Grupi i Punës për Lotin 8, i ngritur me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, me Nr. 375/01 prot., datë 11.03.2016, dhe Nr. 32 datë 11.03.2016, “Për ngritjen e grupit të punës “Për monitorimin, mbikqyrjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratave, si dhe marrjen në dorëzim të produktit, për tenderin “Shërbim Konsulencë”, me objekt “Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për 26 bashkitë”, i ndarë në lote”.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik, BOLLES+WILLSON GmbH&CO dhe IDRA sh.p.k., me anë të shkresës Nr. 17 prot., datë 08.04.2016, protokolluar me tonën Nr. 711 prot., datë **12.04.2016**, kanë dorëzuar në Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Analiza dhe Vlerësimi i Territorit - Bashkia Pogradec;
2. Analiza dhe Vlerësimi i Territorit – Bashkia Korçë;
3. CD.

Dokumentet e mësipërme dorëzohen në zbatim të kontratës me objekt “Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për bashkitë: POGRADEC, KORÇË” Nr. 514 prot., datë **27.01.2016**, lidhur mes Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Bashkimit të Operatorit ekonomik BOLLES+WILLSON GmbH&CO dhe IDRA sh.p.k.; sipas Termave të Referencës bashkëlidhur kontratës ato përbëjnë Dokumentin e fazës së parë të dorëzimeve: “Analiza dhe Vlerësimi i Territorit”.

Nr.	Dorëzimi	Afati	Data
0.	Nënshkrimi i Kontratës	18 javë	27.01.2016
1.	Vlerësimi dhe Raporti i Analizës	6 javë + 4 javë shtesë (plotësim)	09.03.2016 06.04.2016
2.	Strategjia Territoriale	4 javë + 2 javë këshillim	15.05.2016 29.05.2016
3.	Projekt-plani i Zhvillimit të Territorit dhe Rregullorja e Planit	4 javë + 2 javë këshillim	07.07.2016 21.07.2016
4.	Dorëzimi Final	Pas procesit të këshillimit / takimit publik	21.07.2016
5.	Miratimi i Planit në KKT		

Në zbatim të Urdhrit të Ministres Nr. 48, datë 17.02.2016 "Për monitorimin, mbikqyrjen, ndjekjen dhe zbatimin e kontratave, si dhe marrjen në dorëzim të produktit, për tenderin "Shërbim Konsulence", me objekt "Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për 26 bashkitë", i ndarë në lote" si dhe detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit vendor, AKPT ka kryer kontrollin e përputhshmërisë së dokumentit "Analiza dhe Vlerësimi i Territorit", për të cilin është përgatitur Raporti i Vlerësimit Teknik. Grupi i punës e gjen përmbajtjen e këtij dokumenti në përputhje me Termat e Referencës së kontratës me objekt "Hartimi i planeve të përgjithshme vendore për bashkitë: POGRADEC, KORÇË", me kusht* që në produktin përfundimtar të Analizës dhe Vlerësimit të Territorit të reflektohen të gjitha komentet dhe rekomandimet e bëra sipas pikave të raportit bashkëlidhur. Dokumenti përfundimtar i Analizës dhe Vlerësimit të Territorit të dorëzohet në përfundim të fazës pasardhëse: Strategjia Territoriale. Është i nevojshëm që materiali hartografik, raporti dhe përpunimet në formatin GIS, të jenë të veçanta për secilën nga bashkitë e Lot 8.

* Përputhja me kusht jepet duke marrë parasysh kushtet në të cilat është hartuar Analiza e Territorit: mungesa / vonesa e të dhënave të vëna në dispozicion nga institucione qendrore dhe vendore.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali gjendet:

- Raporti i Vlerësimit Teknik për dokumentin "Analiza dhe Vlerësimi i Territorit", për **Bashkinë Pogradec**.
- Raporti i Vlerësimit Teknik për dokumentin "Analiza dhe Vlerësimi i Territorit", për **Bashkinë Korçë**.

Proces-verbali përmban 2 (dy) faqe gjithsej, përpilohet në 5 (pesë) kopje dhe nënshkruhet nga anëtarët e Grupit të Punës për Lotin 8:

Z. Pirro Anastasi

Koordinator

Znj. Esra Trepçi

Koordinator

Z. Evio Baruti

Ekspert GIS

Znj. Borana Laçi

Eksperte Ligjore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
PËR ANALIZËN DHE VLERËSIMIN E TERRITORIT

BASHKIA POGRADEC

Koordinator

Z. Pirro Anastasi

Koordinator

Znj. Esra Trepçi

Ekspert GIS

Z. Evio Baruti

Eksperte Ligjore

Znj. Borana Laçi

20.04.2016

Rezultatet dhe Detyrat		Përputhshmëria me VKM.671, dt. 29.07.2015 dhe Termat e Referencës për Hartimin e PPV
REZULTATI 1. Analiza e të gjitha planeve ekzistuese, strategjive, politikave, normave dhe standarteve		
1.2. Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë	1.2.1. Analiza e planeve, strategjive, planeve sektoriale në të gjitha nivelet, përfshirë zbatueshmërinë e tyre dhe çështje që duhet të vlerësohen gjatë hartimit të planit të ri.	<i>Në përputhje.</i> <i>I nevojshëm pasqyrimi i rolit apo impaktit, të Bashkisë Pogradec, me këto dokumente.</i>
1.3. Dokumentimi dhe rishikimi i direktivave të planeve ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale, standarteve dhe normave.	1.3.1. Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësishme kombëtare që ndodhen në territorin e njësisë së qeverisjes vendore dhe kufizimet që rrjedhin prej tyre.	<i>Në përputhje, sygjerohet pasurimi me zonat e objektet e rëndësishme kombëtare sipas kategorisë së mbrojtjes.</i>
	1.3.2. Analiza e elementeve përjashtuese dhe paraqitjen e tyre grafike në hartë.	<i>I nevojshëm specifikimi i elementeve përjashtuese në vijim të pikës 1.3.1., i zonave të tyre buferike, dhe paraqitja e tyre në një hartë të veçantë.</i>
REZULTATI 2. Skanimi i territorit dhe vlerësimi		
2.1. Vështrimi i Përgjithshëm dhe Analiza Mjedisore	2.1.1. Analiza dhe vlerësimin i pozicionimit strategjik të njësisë së qeverisjes vendore në raport me rajonin ku ajo shtrihet, përfshirë identitetin historik, urban dhe ekonomik të territorit.	<i>I nevojshëm pasqyrimi i vlerësimit të pozicionimit strategjik të njësisë së qeverisjes vendore në raport me rajonin në hartat specifike.</i>
	2.1.2. Analiza e përgjithshme e gjendjes ekzistuese të territorit të njësisë vendore dhe atë metabolike të flukseve kryesore, e cila përmban elementet: <i>i) topografik dhe klimatik; ii) gjeologo-inxhinierik; iii) hidrogjeologjik dhe hidrografik; iv) makrozonimin dhe, sipas rastit, mikrozonimin sizmik; v) bonitetin e tokave, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës; vi) burimet natyrore, si mjedise pyjore, kullota, sipërfaqe ujore, rezervate,</i>	<i>I nevojshëm pasqyrimi në hartën specifike: -pika i), analizës klimatike; -pika v), analizës së bonitetit të tokave.</i>

	<i>miniera dhe të tjera të kësaj natyre, nëse ka të tilla në territorin përkatës; vii) zonat e mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë kulturore dhe historike, nëse ka të tilla në territorin përkatës.</i>	
	2.1.3. Analiza mjedisore	<i>Në përputhje.</i>
	2.1.4. Analiza e problematikës mjedisore, burimeve ndotëse dhe të dhëna për efektin e tyre në territor dhe shëndetin e njeriut	<i>Në përputhje.</i>
	2.1.5. Analiza e përgjithshme e kushteve dhe të cilësisë fizike të strukturave e të territoreve, si bazë për hartimin e planeve të rigjenerimit, ripërtëritjes dhe/ose rrizhvilimit	<i>I nevojshëm plotësimi i degradimit natyror të terrenit dhe degradimit urban.</i>
	2.1.6. Analiza e tipologjisë hapësinore ekzistuese, bazuar në njëtrajtshmërinë e llojit dhe volumit të strukturave, mënyrën e vendosjes së tyre në njësi (strukturore), skemën e rrjetit rrugor dhe të hapësirave publike, si dhe në lartësinë e strukturave	<i>Në përputhje, sygjerohet pasqyrimi në një hartë të integruar e tipologjive të hapësirave.</i>
	2.1.7. Analiza e elementeve të rëndësishme territoriale, natyrore apo artificiale, që kanë ndikuar ose ndikojnë në formimin e vazhdueshëm të territorit në studim	<i>Në përputhje.</i>
2.2. Përdorimi Ekzistues i Tokës; Aktivitetet dhe Impaktet	2.2.1. Analiza e përdorimit ekzistues të tokës, bazuar në kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës, funksionet dhe aktivitetet, si dhe lidhjen e territorit vendor me rrjetet e infrastrukturave kombëtare	<i>E nevojshme paraqitja në një hartë të veçantë të katërmbëdhjetë kategorive bazë, sipas specifikimeve të Nenit 77 të VKM Nr. 671 datë 29.07.2015.</i>

**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT
BASHKIA POGRADEC**

2.3. Analiza dhe Vlerësimi Demografik	2.3.1. Shpërndarja dhe përqëndrimi i popullsisë në territor, lëvizjet mekanike dhe natyrore në vite	<i>Në përputhje.</i>
2.4. Aspektet Sociale dhe Ekonomike	2.4.1. Analiza dhe vlerësimi ekonomik, përfshirë mundësitë lokale dhe pengesat për zhvillim ekonomik, konkurrueshmërinë ekonomike apo rajonale, pozicionimin dhe përqendrimin e poleve ekonomike lokale, cilësinë e kapitalit dhe të burimeve njerëzore, pika të forta apo të dobëta për zhvillimin e ardhshëm të territorit	<i>Në përputhje.</i>
	2.4.2. Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale, përfshirë kriminalitetin, komunitetet e marginalizuara, etj.	<i>Në përputhje.</i>
	2.4.3. Analiza e zhvillimit social, punësimit, edukimit, shëndetit etj.	<i>Në përputhje.</i>
	2.4.4. Analiza e periferialitetit, për efekt të së cilës në territor përcaktohen zona sipas kriterëve të mëposhtme: i) largësia nga qendra/t e territorit urban; ii) largësia nga zonat ekonomike (qendrat e punësimit); iii) lidhja me rrjetin rrugor sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Rrugor; iv) furnizimi me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale; v) niveli i përafërt i të ardhurave të shtresave shoqërore që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zona të caktuara; vi) plotësimi me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës; vii) niveli i kriminalitetit dhe siguria e jetës; viii) probleme të ndryshme sociale, përfshirë përjashtimin social;	<i>Në përputhje, sygjerohet përcaktimi sipas kriterit të pikës iii) lidhja me rrjetin rrugor sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Rrugor.</i>

	2.4.5. Analiza e nevojave për strehim për të gjitha grupet shoqërore, sipas llojit dhe cilësisë së banesave ekzistuese, shpërndarjes së tyre në territor, sipërfaqes së banimit për person dhe aksesit në shërbime	<i>Në përputhje.</i>
2.5. Analiza e Infrastrukturës Ekzistuese	2.5.1. Infrastruktura rrugore, transporti dhe fluksi i lëvizjes së mjeteve (njësi/orë)	<i>I nevojshëm pasurimi me fluksin e lëvizjeve të mjeteve (njësi/orë) dhe analizën e rrjetit rrugor sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Rrugor.</i>
2.6. Toka dhe Çështjet e Pronës	2.6.1. Analiza e mënyrës së përdorimit të pronave publike, përfshirë vendndodhjen, funksionet dhe marrëdhëniet e pronësisë	<i>Në përputhje, i nevojshëm pasurimi i informacionit në hartë me detajet e përdorimit të tokës.</i>
	2.6.2. Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën, përfshirë konfliktet dhe situatat e informalitetit	<i>I nevojshëm pasurimi me informacionin e zonave për të cilat nuk ka informacion, dhe evidentimi i konflikteve dhe situatave të informalitetit.</i>
REZULTATI 3. Përgatitja e databazës territoriale e integruar në platformën GIS		
3.1. Analiza e Situatës Aktuale	3.1.1. Analizimi i situatës së inventarit të të dhënave, “hardëare” dhe “softëare”, burimeve njerëzore, etj.	<i>Në përputhje.</i>
	3.1.2. Rekomandimi i veprimeve dhe masave për rritjen e efikasitetit të GIS	<i>Në përputhje.</i>
3.2. Përditësimi i të Dhënave Ekzistuese	3.2.1. Krijimi i strukturës për së paku: - Ndërtesat: numrat e kateve, funksionet, kushtet; - Infrastruktura rrugore: klasifikimi, kushtet; - Burimet ujore dhe infrastruktura e shërbimeve; - Përdorimi i tokës; - Zonat mbrojtëse të zonave të ndjeshme sipas legjislacionit shqiptar, të tilla si rrugët, uji, landfill, etj.	<i>I nevojshëm plotësimi i të gjitha shtresave, plotësimi në projeksionet përkatëse dhe azhurnimi i mëtejshëm i territorit, duke mos u kufizuar vetëm në territorin e ish-Bashkisë Pogradec. Konturimi i shtresave duhet të jetë vetëm për bashkinë, e jo për territore më të gjëra.</i>

**RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK
ANALIZA DHE VLERËSIMI I TERRITORIT
BASHKIA POGRADEC**

3.3. Krijimi i Strukturës së Bazës së të Dhënave	3.3.1. Konvertimi i inventarit të bashkisë në formatin e Regjistrit të Integruar të Territorit.	<i>I nevojshëm konvertimi i databazës së përgatitur në formatin e përcaktuar nga AKPT.</i>
	3.3.2. Përgatitja e strukturës së bazës së të dhënave dhe një plani veprimi për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave.	<i>I nevojshëm plotësimi i rezultatit me këtë fokus.</i>

